



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 83 Dt. 14.02.2023

PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të kërkesës për inicim te procedurës disiplinore nga Komisioni i Garave, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 14.02.2023, merr këtë:

VENDIM

I. SHQIPTOHET pezullimi i Lindrit Misinit (zyrtar i KB Trepça).

ARSYETIM

Me datë 08.02.2023, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore nga Komisioni i Garave të FBK-së lidhur me incidentin në ndeshjen mes KB Trepça dhe KB Golden Eagle Ylli, xhiroja XX e Prince Caffè Superligës së Kosovës (edicioni 2022/23).

Incidenti në fjalë ka të bëjë me trazirat pas ndeshjes së cekur, ku supozohet se, Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës) ka tentuar të sulmojë fizikisht gjyqtarin Elldin Uglari.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 10.02.2023 dhe më 14.02.2023. Para takimit, Sekretarja e Përgjithshme e FBK është autorizuar nga KD për të kërkuar deklaratat nga akterët e përfshirë në këtë rast. Komisioni Disiplinor ka pasur në dispozicion deklaratat nga: Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës), Elldin Uglari (gjyqtar i ndeshjes), Dren Pudarolli (gjyqtar i ndeshjes), dhe Artan Gashi (gjyqtari kryesor i ndeshjes).

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar deklaratat në dispozicion dhe ka ardhur në përfundim se provat nuk mjaftojnë për të marrë vendim përfundimtar. Si rrejdhojë, në bazë të nenit 39 të Rregullores Disiplinore, deri në marrjen e vendimit final, Lindrit Misinit i shqiptohet pezullimi 7 ditë nga pozita e tij si zyrtar i paraqitur në dokumentacionin e KB Trepça në FBK.

Omer Daku

Kryetar i Komisionit Disiplinor të FBK-së



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

